



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:262680

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747201

KPPP.nr.610/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Malësia” SH.P.K., me NUI: 810196487, me seli në rr. “Hamid Kokalari” pn, në Gjilan, kundër debitorit D.P.H. Hamburger “Dafina”, me NUI: 810338691, me seli në Fshatin Koretin, në Kamenicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Vlora Berisha, avokate nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.757/23 të datës 27.10.2023 të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit D.P.H. Hamburger “Dafina”, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.757/23 i datës 27.10.2023, i Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj debitorit shumën prej 208.00 € (dyqind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Malësia” SH.P.K., me seli në Gjilan, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.757/23 të datës 27.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 4250/23 të datës 13.10.2023; me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguajë kreditorit shumën prej 64,123.70 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e lejimit deri në datën e pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, ashtuqë që përmbartuesi borxhin t’ a

inkasoi me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse të përmbaruesit privat në llogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtuqë të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar ndër të tjerash se në rastin konkret kemi të bëjmë me një faturë që nuk përbën dokument të besueshëm, e të cilës i mungon nënshkrimi i debitorit, gjithashtu i mungon edhe përshkrimi i sasisë dhe çmimit të produkteve të mishit dhe nga e njëjta si borxh i mbetur figuron vlera 66,090.50 € e vitit 2023, por që debitori nuk i ka mbetur borxh kreditorit, duke shtuar që fatura në fjalë është fiktive, për faktin se kjo shumë nuk përkon me gjendjen reale.

I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për përmbarim dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës përmbarimore, si dhe shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumën prej 208.00 € sipas TOAK.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar ndër të tjera se urdhri përmbarimor bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht në faturën, e cila është pranuar nga debitori me datë 18.10.2023 dhe se dorëzimi i faturës është bërë me postë gjë e cila vërtetohet nga fletëdorëzimi dhe nga fletëkthesa. Më tutje ka shtuar se ka kërkuar drejtpërdrejt tek debitori që të paguaj obligimin që i ka mbetur kreditorit. Në lidhje me pretendimet e debitorit se lokali është i mbyllur ka theksuar që një gjë e tillë nuk qëndron sepse biznesi i debitorit rezulton të jet aktiv në ARBK, ndërsa në lidhje me pretendimet se debitori ka përmbushur detyrimet e tij ka theksuar që i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fletëpagesë.

Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri mbi lejimin e përmbarimit dhe të obligohet debitori t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës përmbarimore si dhe shpenzimet e tjera sipas TOAK.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 4250/23 e datës 13.10.2023, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm përmbartimor po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi përmbartimor paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, e njëjta nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm.

Gjykata po ashtu shqyrtoi pretendimin e kreditorit se fatura e lartcekur është pranuar përmes postës, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është në tërësi i pa bazuar, pasi që nga fletëkthesa e postës nuk mund të vërtetohet lloji i dërgesës të cilën e ka pranuar debitori, meqenëse në dëftesën e pranimin me nr. Serik 222012023630630 të datës 13.10.2023, nuk është përshkruar fare dërgesa e cila i është dorëzuar debitorit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilat mbështetet propozimi përmbartimor, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm pasi që nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të neneve 452 par.1, 453 dhe 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur debitorit shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe atë në shumën prej 208.00 €.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.610/24, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.